



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit

Data	
Nr. Prot	

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN

PËR

PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË FUSHË - ARRËZ, ME KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË SOCIALDEMOKRATE, ZJ. VJOLLCA NDOC TABAKAJ

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Me shkresën nr. 3370 prot., datë 8.11.2023, Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Nikolin Stak Marku, propozuar nga subjekti politik Partia Socialdemokrate.

Referuar nenit 164, paragrafi 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate për këshillin e bashkisë Fushë-Arrëz, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 4. zj. Vjollca Ndoc Tabakaj.

Me shkresën nr. 7653 prot., datë 20.11.2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në këshillin e bashkisë Fushë-Arrëz, zj. Vjollca Ndoc Tabakaj, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit Partia Socialdemokrate, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 43 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Vjollca Ndoc Tabakaj, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, me shkresën nr.7841 prot., datë 13.12.2023 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr.7842 prot., datë 13.12.2023 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për zj. Vjollca Ndoc Tabakaj.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr.18271/1 prot., datë 20.12.2023, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Vjollca Ndoc Tabakaj, në këshillin e bashkisë Fushë-Arrëz, ku konstatohet se kandidati ka ndryshime në përbërësit e gjëndjes civile, ka ndryshuar rubrikën e mbiemrit pas martesë nga Delia në Tabakaj.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr.16144/1 prot., datë 22.12.2023, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Vjollca Ndoc Tabakaj, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Vjollca Ndoc Tabakaj, në këshillin e bashkisë Fushë-Arrëz, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

Majlinda ÇELMETA - Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve

Ylli MERKAJ - Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË FUSHË - ARRËZ, ME KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË SOCIALDEMOKRATE, ZJ. VJOLLCA NDOC TABAKAJ

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 3370 prot., datë 8.11.2023, Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Nikolin Stak Marku, propozuar nga subjekti politik Partia Socialdemokrate.

Referuar nenit 164, paragrafi 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumëmemërore e Partisë Socialdemokrate për Këshillin e Bashkisë Fushë-Arrëz, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 4. zj. Vjollca Ndoc Tabakaj.

Me shkresën nr. 7653 prot., datë 20.11.2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Fushë-Arrëz, zj. Vjollca Ndoc Tabakaj, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456
Ora: hh:mm



“Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Fushë-Arrëz me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Socialdemokrate zj. Vjollca Ndoc Tabakaj”

të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit Partia Socialdemokrate, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 43 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Vjollca Ndoc Tabakaj, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja "b" dhe pika 3, shkronja "c", të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, me shkresën nr.7841 prot., datë 13.12.2023 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr.7842 prot., datë 13.12.2023 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për zj. Vjollca Ndoc Tabakaj.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr.18271/1 prot., datë 20.12.2023, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Vjollca Ndoc Tabakaj, në Këshillin e Bashkisë Fushë-Arrëz, ku konstatohet se kandidati ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile, ka ndryshuar rubrikën e mbiemrit pas martesë nga Delia në Tabakaj.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr.16144/1 prot., datë 22.12.2023, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Vjollca Ndoc Tabakaj, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Vjollca Ndoc Tabakaj, në Këshillin e Bashkisë Fushë-Arrëz, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreun V, të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Fushë-Arrëz, me kandidatin nga lista shumëmbërore e Partisë Socialdemokrate, zj. Vjollca Ndoc Tabakaj.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI